




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK KORÇË

Nr. 117 Prot.

Korçë, më 19.02.2025

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN  
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të Udhëzimit Nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", Qendra e Formimit Profesional Publik, Korçë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin Instrukturë me kohë të pjesshme të kursit: KUZHINË, AFTËSIM DREJT PUNËSIMIT, SERVIS XHENERIK NË AUTOMJETET E LEHTA, PARUKERI/ESTETIKË, RROBAQEPSI, BERBER, MANIKYR – PEDIKYR, GRAFIK DIZAJN, SEKRETARI, INSTALIM DHE MIRËMBAJTJE E RRJETIT ELEKTRIK, INSTALIME DHE MIRËMBAJTJE HIDRAULIKE, AFTËSI DIGJITALE, GJUHË ANGLEZE (IEVP), MOBILERI

- Pozicionet:

- a) Instruktur të kursit KUZHINË ---- 3 persona
- b) Instruktur të kursit AFTËSIM DREJT PUNËSIMIT ---- 2 persona
- c) Instruktur të kursit SERVIS XHENERIK NË AUTOMJETET E LEHTA ---- 2 persona
- d) Instruktur të kursit PARUKERI ---- 1 person
- e) Instruktur të kursit RROBAQEPSI ---- 1 person
- f) Instruktur të kursit BERBER ---- 1 person
- g) Instruktur të kursit MANIKYR – PEDIKYR ---- 1 person
- h) Instruktur të kursit GRAFIK DIZAJN ---- 1 person
- i) Instruktur të kursit SEKRETARI ---- 1 person
- j) Instruktur të kursit INSTALIM DHE MIRËMBAJTJE E RRJETIT ELEKTRIK ---- 2 persona
- k) Instruktur të kursit INSTALIME DHE MIRËMBAJTJE HIDRAULIKE ---- 1 person
- l) Instruktur të kursit AFTËSI DIGJITALE ---- 2 persona
- ll) Instruktur të kursit GJUHË ANGLEZE (IEVP) ---- 1 person
- m) Instruktur të kursit MOBILERI ---- 1 person

## 1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për levizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

## 2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi;
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 26.02.2025

DREJTOR I KOMANDUAR

Adela MYTEBERI

